

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-068/15

Prishtinë, 18 maj 2016

Në çështjen juridike të:

R. S.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit, Beshir Islami, gjyqtar dhe Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08625), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 18 maj 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA08625.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA08625.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 22 janar 2007, R.S.(në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), të regjistruar me numrin e lëndës KPA08625, ku kërkon ri-posedimin e ngastrës nr.52 me sipërfaqe prej 1.08.57 Ha dhe ngastrës nr.53 me sipërfaqe prej 0.69.04 Ha, të dyja të ndodhura në Granica - Do bara, Merdarë, Komuna e Podujevës.
2. Në kërkesë pala ankuese ka theksuar se ngastrat e sipërpërmendura janë uzurpuar nga UNMIK-u, Shërbimi Doganor i Kosovës dhe Shoqata e Sigurimeve të Kosovës në gusht të vitit 2002.
3. Kërkesa fillestare ishte ndarë për shkak të ndarjes dhe shitjes së disa pjesëve të ngastrave të sipërpërmendura. Si rezultat, kërkesa fillestare kishte mbetur me ngastrën nr.53/2 me sipërfaqe prej 00.29.15 Ha. (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).
4. Së bashku me kërkesën pala ankuese kishte dorëzuar *inter alia* në AKP:
 - Aktvendimin e Trashëgimisë T.nr.172/06 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kurshumli, Serbi me të cilin pala ankuese ishte shpallur si trashëgimtar i vetëm i pronës së kërkuar pas vdekjes së babait të tij M.S.
 - Fletën poseduese nr. 88 të lëshuar nga Zyra Kadastrale për Pronë të Paluajtshme në Podujevë, ku babai i palës ankuese ceket si pronar i vetëm i pronës së kërkuar.
 - Certifikatën e vdekjes nr.203-1125/07 të lëshuar nga Komuna e Prokupljes, Serbi, që vërteton se babai i palës ankuese M. S. kishte ndërruar jetë më 12 dhjetor 2005.
5. Më 24 shtator 2007 AKP-ja kishte gjetur ex officio fletën poseduese të lartpërmendur.

6. Më 15.08.2013 AKP-ja kishte gjetur ex officio se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të E. S. i cili ishte bërë pronar i pronës në vitin 2011 në bazë të kontratës së shitblerjes.
7. Pala ankuese ishte kontaktuar më 26 gusht 2013 dhe kishte pohuar se ai kishte shitur disa pjesë të ngastrave të cilat janë subjekt i kërkesës fillestare. Pala ankuese nuk kishte dorëzuar as sqarim dhe as ndonjë dokument për shitjen në fjalë.
8. Kërkesa ishte njoftuar fizikisht më 22 nëntor 2013 dhe përmes publikimit në gazetën e AKP-së më 21 shtator 2010. Ekipi njoftues gjeti se prona e kërkuar është kullosë dhe se ajo nuk është e zënë. Askush nuk kishte marrë pjesë në procedurë si palë përgjegjëse në kërkesë.
9. Më 13 mars 2014, KKPK me vendimin e tij KPCC/D/A/228/2014 kishte hedhur poshtë kërkesën me arsyetimin se pala ankuese nuk e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 por si rezultat i shitjes së vullnetshme pas konfliktit.
10. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 8 shtator 2014. Më 7 tetor 2014 pala ankuese kishte paraqitur ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

11. Në ankesën e tij pala ankuese thekson se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së mbështetet mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimin e gabuar të ligjit mbi pronën. Pala ankuese thekson se ai nuk e ka tjetërsuar pronën e kërkuar dhe se ai asnjëherë nuk ka dërguar asnjë njoftim në AKP për ta informuar atë se një tjetërsim i tillë kishte ndodhur ndonjëherë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç përcaktohet në nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar dhe prandaj ajo duhet të refuzohet. Në kërkesë vet pala ankuese thekson se prona e kërkuar është uzurpuar në gusht të vitit

2002 nga UNMIK-u, Shërbimi Doganor i Kosovës dhe Shoqata e Sigurimeve të Kosovës. Prandaj, nuk mund të pretendohet se humbja e posedimit ka të bëjë me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999.

14. Rrjedhimisht, KKPK me të drejtë ka vendosur se lënda bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe si rrjedhojë kishte hedhur poshtë kërkesën. Nuk kishte pasur as shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
15. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it